RELACION SHPJEGUES PËR PROJEKTVENDIMIN

"PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE, KËRKESAVE DHE PROCEDURAVE PËR VENDDEPOZITIMET E PËRKOHSHME TË MBETJEVE INERTE"

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projektakti është përcaktimi i kuadrit rregullator për ngritjen, administrimin dhe funksionimin e venddepozitimeve të përkohshme të mbetjeve inerte, si një zgjidhje tranzitore deri në ndërtimin dhe vënien në funksion të infrastrukturës rajonale përfundimtare për trajtimin e këtyre mbetjeve.

Mbetjet inerte, siç përkufizohen në ligjin nr. 57/2025 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", janë mbetjet të cilat nuk transformohen kimikisht, fizikisht, apo biologjikisht dhe nuk ndërveprojnë kimikisht me lëndë të tjera[1]. Në këtë kategori përfshihen, ndër të tjera dheu i gërmimeve të ndërtimit, si dhe materialet që rezultojnë nga prishja e ndërtimeve.

Në rastet kur këto materiale nuk mund të ripërdoren për qëllime ndërtimi, destinacioni i tyre përfundimtar është depozitimi në landfill-e të dedikuara. Megjithatë, në kushtet kur kjo infrastrukturë nuk është ende plotësisht funksionale, trajtimi i tyre realizohet përmes venddepozitimeve të përkohshme, të cilat janë objekt i këtij projektvendimi.

Hartimi i këtij projektakti mbështetet në kuadrin ligjor në fuqi, konkretisht në nenin 34 të ligjit nr. 57, datë 16.10.2025, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", si dhe në VKM nr. 513, datë 25.9.2025, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Mjedisit", e cila i ngarkon kësaj ministrie përgjegjësinë për hartimin e politikave dhe përcaktimin e standardeve në fushën e menaxhimit të mbetjeve.

[1] "Mbetje inerte" janë ato mbetje që nuk i nënshtrohen ndonjë transformimi të rëndësishëm fizik, kimik apo biologjik. Mbetjet inerte nuk treten, nuk digjen, nuk ndërveprojnë fizikisht dhe as nuk hyjnë në reaksione kimike, nuk biodegradojnë e nuk ndikojnë negativisht në lëndë të tjera, me të cilat bien në kontakt, në mënyrë të tillë që mund të shkaktojnë ndotje të mjedisit ose të dëmtojnë shëndetin e njeriut. Aftësia totale për të lëngëzuar, përmbajtja e ndotësve dhe ekotoksiciteti i lëngjeve kulluese të mbetjeve inerte duhet të jenë të pakonsiderueshme dhe në mënyrë të veçantë nuk duhet të vënë në rrezik cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe/ose të ujërave nëntokësore.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektvendim nuk është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve për vitin 2026. Megjithatë, miratimi i tij konsiderohet i domosdoshëm për shkak të nevojës urgjente për adresimin e fenomenit të depozitimit të pakontrolluar të mbetjeve inerte dhe për plotësimin e një boshlleku të evidentuar në kuadrin rregullator ekzistues.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Në kushtet aktuale, ku infrastruktura rajonale për menaxhimin e mbetjeve inerte mungon ose nuk është ende plotësisht funksionale, depozitimi i pakontrolluar i këtyre mbetjeve përbën një problem të rëndësishëm mjedisor dhe urban.

Në këtë kuadër, për garantimin e funksionimit të njëtrajtshëm dhe të kontrolluar të venddepozitimeve të përkohshme në të gjithë territorin, parashikohet vendosja e një mekanizmi të unifikuar koordinimi për organizimin dhe administrimin e tyre. Kjo qasje nuk synon të zëvendësojë rolin e pushtetit vendor, por të forcojë dhe standardizojë ushtrimin e kompetencave në këtë fushë, duke krijuar kushte për zbatim më efektiv dhe të harmonizuar në nivel territori.

Duke marrë në konsideratë natyrën ndërterritoriale të flukseve të mbetjeve inerte dhe nevojën për standarde të harmonizuara teknike dhe mjedisore, ky koordinim kontribuon në garantimin e praktikave të njëtrajtshme dhe në forcimin e mbrojtjes së mjedisit. Në të njëjtën kohë, ai ruan dhe konsolidon rolin e bashkive në zbatimin në terren dhe në bashkëpunimin institucional.

Kjo ndërhyrje paraqitet si mekanizëm tranzitor, i lidhur me fazën aktuale të zhvillimit të infrastrukturës për trajtimin e mbetjeve, dhe synon krijimin e bazave për një sistem të konsoliduar dhe të qëndrueshëm në të ardhmen.

Hedhja e pakontrolluar e mbetjeve inerte ndikon negativisht në cilësinë e tokës dhe të ujërave sipërfaqësore, dëmton peizazhin natyror dhe krijon rreziqe për shëndetin e komuniteteve. Gjithashtu, ajo sjell pasoja për ekosistemet lokale dhe nxit zhvillimin e praktikave informale në sektorin e ndërtimit.

Në këtë kontekst, projektvendimi paraqet një instrument të domosdoshëm për vendosjen e një kuadri të standardizuar dhe të kontrolluar për menaxhimin e mbetjeve inerte, duke synuar trajtimin e tyre të rregullt dhe të monitoruar deri në funksionalizimin e plotë të landfill-eve rajonale.

Venddepozitimet e përkohshme të mbetjeve inerte konceptohen si vendndodhje të autorizuara, ku depozitimi kryhet në mënyrë të kufizuar në kohë dhe kapacitet, dhe vetëm për mbetje inerte. Ato funksionojnë si infrastrukturë kalimtare brenda sistemit të menaxhimit të integruar të mbetjeve, duke siguruar trajtim të kontrolluar deri në vënien në funksion të landfill-it përkatës.

Në këtë kuadër, operimi dhe administrimi i venddepozitimeve të përkohshme realizohet nga subjekte të autorizuara (operatorë), në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurat përkatëse për lejet e ndërtimit. Përfshirja e operatorëve përbën element thelbësor për garantimin e funksionimit efektiv dhe të standardizuar të sistemit në praktikë, duke siguruar kapacitetet teknike, operacionale dhe logjistike të nevojshme për menaxhimin e përditshëm të tyre.

Kjo qasje forcon mekanizmat e përgjegjshmërisë dhe kontrollit, duke lidhur drejtpërdrejt zbatimin operacional me subjektin përgjegjës për administrimin teknik të procesit, si dhe duke reduktuar fragmentimin institucional në zbatim.

Në këtë mënyrë garantohet zbatim i njëtrajtshëm i standardeve teknike dhe mjedisore, si dhe krijohen kushte për mbikëqyrje të vazhdueshme, monitorim të ndikimit në mjedis dhe raportim të strukturuar mbi gjurmueshmërinë e mbetjeve.

Ky projektvendim krijon një sistem të detyrueshëm gjurmueshmërie, ku çdo transfertë mbetjesh dokumentohet, duke mundësuar monitorimin në kohë reale të volumeve të gjeneruara nga industria e ndërtimit. Efekti i pritshëm është krijimi i një stacioni tranzit të rregulluar, i cili lehtëson barrën mjedisore të bashkive dhe disiplinon subjektet ndërtuese deri në funksionalizimin e plotë të landfilleve rajonale.

Kjo qasje siguron menaxhim të unifikuar dhe të standardizuar të mbetjeve inerte, përmes mbikëqyrjes efektive, monitorimit të vazhdueshëm dhe raportimit të strukturuar, si dhe synon reduktimin e depozitimit të paligjshëm dhe rritjen e transparencës përgjatë gjithë ciklit të tyre.

Efektet e pritshme të miratimit të këtij projektvendimi janë përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve inerte në nivel kombëtar, reduktimi i ndikimeve negative në mjedis, rritja e kontrollit dhe gjurmueshmërisë, si dhe krijimi i një sistemi tranzitor funksional deri në ndërtimin e infrastrukturës përfundimtare. Gjithashtu,

pritet përmirësimi i koordinimit institucional ndërmjet aktorëve përgjegjës dhe zbatim i harmonizuar i kërkesave ligjore dhe mjedisore.

Në përfundim, projektvendimi përbën një ndërhyrje të domosdoshme, proporcionale dhe të balancuar, që mbyll boshllëkun rregullator ekzistues, parandalon informalitetin dhe ndotjen, dhe krijon një urë të qartë tranzitore drejt funksionalizimit të plotë të infrastrukturës rajonale përfundimtare. Për këtë arsye, miratimi i tij forcon kapacitetin shtetëror për menaxhimin e mbetjeve inerte dhe garanton zbatim të qëndrueshëm të kuadrit ligjor në fuqi.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektvendim është i mbështetur në nenin 100 të Kushtetutës dhe të nenit 34, të ligjit nr. 57, datë 16.10.2025, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve".

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projektakti nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me programin e përafrimit me acquis communautaire të Bashkimit Evropian, në kuptimin e transpozimit të një akti të veçantë të BE-së. Megjithatë, dispozitat e tij janë hartuar në përputhje me parimet e përgjithshme të legjislacionit të Bashkimit Evropian në fushën e menaxhimit të mbetjeve, veçanërisht sa i përket hierarkisë së menaxhimit të mbetjeve dhe ekonomisë qarkulluese.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi përmban një total prej 16 nenesh, të cilat përcaktojnë në mënyrë të detajuar rregullat, kërkesat dhe procedurat për venddepozitimet e përkohshme të mbetjeve inerte, duke mbuluar të gjithë ciklin e tyre të jetës, nga ngritja deri te mbyllja dhe rehabilitimi. Ky projektvendim synon të krijojë një kuadër të qartë dhe të qëndrueshëm për menaxhimin e mbetjeve inerte, duke adresuar

problematikat ekzistuese dhe duke garantuar respektimin e legjislacionit dhe parimeve të mbrojtjes së mjedisit.

Në nenet e para, nga neni 1 deri në nenin 4, përcaktohet qartësisht objekti dhe qëllimi i projektvendimit, duke shpjeguar se ai ka për qëllim rregullimin e venddepozitimeve të përkohshme të mbetjeve inerte dhe të gjithë proceseve të lidhura me to. Gjithashtu, këto nene përcaktojnë fushën e zbatimit dhe japin përkufizime kyçe, duke sqaruar konceptet e mbetjeve inerte, venddepozitimeve të përkohshme dhe kriteret teknike të ndërtimit dhe operimit të tyre, në mënyrë që të shmangen ndikimet negative në mjedis dhe të sigurohet planifikimi në përputhje me politikat kombëtare.

Nenet 5 dhe 6 trajtojnë kriteret e ngritjes së venddepozitimeve, duke specifikuar kushtet e sigurisë, vendndodhjes dhe përshtatshmërisë mjedisore. Në këtë pjesë sqarohen edhe llojet e mbetjeve që pranohen dhe ato të ndaluara, duke vendosur kufij të qartë për çfarë mund të depozitohet dhe çfarë duhet të shmanget. Ky grup dispozitash është themelor për të siguruar që çdo venddepozitim të ndërtohet dhe menaxhohet në përputhje me standardet teknike dhe mjedisore, duke reduktuar rrezikun për shëndetin e njerëzve dhe për mjedisin.

Nenet 7 deri në 10 përcaktojnë procedurat administrative për miratimin e venddepozitimeve dhe dokumentacionin e nevojshëm për këtë proces. Dokumentacioni i kërkuar përfshin projektet teknike dhe mjedisore, afatet e shqyrtimit dhe kriteret e verifikimit, duke siguruar që çdo venddepozitim të jetë në përputhje me standardet ligjore dhe mjedisore.

Nenet 11 dhe 12 përcaktojnë detyrimet e operatorëve të autorizuar në menaxhimin e venddepozitimeve të përkohshme, duke garantuar që, pas përfundimit të afatit të përkohshmërisë, operatori është i detyruar ta kthejë sheshin në gjendjen fillestare ose ta rehabilitojë atë sipas kushteve teknike të miratuara. Operatorët e autorizuar kryejnë funksionin operativ të venddepozitimit, duke përfshirë mirëmbajtjen, sigurinë, raportimin periodik dhe respektimin e kërkesave teknike.

Kjo qasje siguron që çdo venddepozitim të menaxhohet në mënyrë të unifikuar, me përgjegjësi të qarta ndërmjet aktorëve operativë dhe institucioneve mbikëqyrëse, dhe të funksionojë mbi bazën e kërkesave teknike të përcaktuara në këtë vendim dhe në anekset e tij. Njëkohësisht, trajtohen procedurat e pranimit, transportit, monitorimit dhe raportimit të mbetjeve, duke garantuar gjurmueshmëri dhe kontroll të vazhdueshëm mbi lëvizjen dhe depozitimin e tyre. Këto dispozita synojnë të parandalojnë keqpërdorimet, të sigurojnë transparencë

dhe të mbajnë një evidencë të detajuar për të gjithë ciklin e jetës së mbetjeve në venddepozitimet e përkohshme.

Neni 13 përqendrohet te mbyllja dhe rehabilitimi i venddepozitimeve. Ato përshkruajnë procedurat dhe detyrimet, që duhet të ndiqen për të siguruar pastrimin e zonës, rikthimin e saj në gjendje të sigurt si dhe ndërmarrjen e

masave për minimizimin e ndikimit mjedisor pas përfundimit të funksionimit të venddepozitimit.

Ky projektvendim integron për herë të parë një detyrim të qartë për rikuperimin e mbetjeve inerte, në përputhje me parimet e Direktivës 2008/98/EC dhe objektivat e ekonomisë qarkulluese të Bashkimit Evropian, si dhe praktikat e përdorimit të materialeve të ricikluara në ndërtim.

Përcaktimi i koeficientëve teknikë dhe kuotave të rikuperimit përbën një instrument të nevojshëm rregullator për zbatimin praktik të këtij ligji.

Nisma bazohet në parimet themelore të ekonomisë qarkulluese, si transformimi i mbetjeve në burim ekonomik, minimizimi i depozitimit në landfill dhe zëvendësimi i materialeve natyrore me materiale sekondare. Vendosja e një kuote minimale rikuperimi prej 45% dhe një kufiri maksimal prej 55% për depozitimin final siguron një ndarje të detyrueshme ndërmjet rikuperimit dhe asgjësimit, duke orientuar sistemin drejt përdorimit efikas të burimeve.

Neni 11 i Direktivës 2008/98/EC përcakton që të paktën 70% e mbetjeve të ndërtimit dhe prishjes duhet të rikuperohen (ripërdorim, riciklim dhe backfilling). Kuota 45% është plotësisht në përputhje me acquis dhe përfaqëson një nivel tranzitor realist, si dhe krijon bazën për arritjen graduale të objektivit 70%. Kjo nismë operacionalizon këto parime në nivel kombëtar dhe i kthen në detyrime të matshme dhe të monitorueshme.

Shqipëria ndodhet në një fazë tranzitore të zhvillimit të sistemit të menaxhimit të mbetjeve, ndërsa infrastruktura për trajtimin e mbetjeve inerte është ende e kufizuar dhe niveli aktual i rikuperimit mbetet nën standardet e Bashkimit Evropian. Në këtë kontekst, vendosja e një objektivi 45% rikuperim çdo 6 muaj është teknikisht e arritshme, administrativisht e monitorueshme dhe shmang vendosjen e objektivave të paarritshme në afat të shkurtër.

Përcaktimi i dendësisë (ρ), koeficientit të kompaktimit, koeficientit të shfrytëzimit të sipërfaqes dhe rezervës operative garanton dimensionimin korrekt të landfill-eve, shmangien e mbingarkesës së kapaciteteve dhe optimizimin e investimeve publike.

Në tërësi, ky projektvendim ofron një qasje të plotë dhe të monitoruar për menaxhimin e venddepozitimeve të përkohshme të mbetjeve inerte, duke mbuluar çdo fazë të ciklit të tyre dhe duke krijuar një sistem të qartë, të qëndrueshëm dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe parimet e mbrojtjes së mjedisit.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E KËTIJ AKTI

Për zbatimin e këtij projekvendimi ngarkohen institucionet përgjegjëse pjesë përbërëse e tij.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektvendimi u hartua bazuar në nenin 34, pika 10 e ligjit nr. 57, datë 16.10.2025, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve". Projekt akti është hartuar nga strukturat përgjegjëse të Ministrisë së Mjedisit.

Projektvendimi u dërgua për mendim tek Ministria e Financave, Ministria e Drejtësisë, Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, të cilat janë shprehur si më poshtë vijon:

Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, është shprehur parimisht dakord me sugjerimin që projektvendimi të shqyrtohet paraprakisht nga Këshilli Konsultativ i Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore.

Lidhur me komentin mësipërm sqarojmë se ky akt synon të trajtojë një situatë të veçantë dhe të përkohshme për menaxhimin e mbetjeve inerte. Venddepozitimet e përkohshme janë konceptuar për t'u përdorur vetëm për një periudhë të kufizuar tranzitore, deri në ndërtimin dhe vënien në funksion të infrastrukturës rajonale të menaxhimit të integruar të mbetjeve, që do të administrohet nga AKEM sh.a. Për këtë arsye, organizimi i tyre nuk ndjek skemën e zakonshme të menaxhimit të mbetjeve në nivel bashkie, por është ndërtuar si një zgjidhje e centralizuar në nivel kombëtar. Në këtë kuadër, zhvillimi dhe administrimi i kësaj infrastrukture realizohet përmes AKEM sh.a., e cila vepron në shkallë kombëtare dhe bashkërendon këtë proces në mënyrë të unifikuar. Roli i bashkive në fushën e menaxhimit të mbetjeve vijon të ushtrohet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kuadrin e përgjithshëm rregullator.

Ministria e Drejtësisë:
Lidhur me komentin për rishikimin e shkronjave "b" dhe "c", të pikës 2, të nenit 10, si dhe të përkufizimit të termit "operator", në shkronjën "b", të nenit 3, të projektvendimit, me argumentin se AKEM sh.a. operon vetë në veprimtarinë objekt të projektaktit dhe se delegimi i kësaj kompetence nuk mund të parashikohet në përmbajtjen e projektvendimit, sqarojmë se projektvendimi u rishikua në harmonizim me parashikimet e pikën 5, të nenit 22, të ligjit nr. 57/2025, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve". Konkretisht, u rishikua shkronja "b" e nenit 3 si dhe u saktësuan dhe u riformuluan parashikimet e nenit 10, duke lënë detyrimet e përgjithshme të operatorit si pikë 2, përfshirë edhe detyrimet e AKEM sh.a. Ndërkohë parashikimet e pikës 3, të nenit 10, detyrimet e AKEM sh.a, janë në përputhje me parashikimet e pikës 4, të nenit 22, i cili parashikon shprehimisht që AKEM mund të krijojë shoqëri dhe degë dhe në harmonizim me shkronjat "b" dhe "c" të pikës 5, të këtij neni, që parashikojnë administrimin dhe ngritjen e infrastrukturës fundore. Për rrjedhojë këto parashikime nuk kanë si qëllim delegimin e kompetencave të AKEM sh.a., por detajojnë rregullimin e mënyrës së ushtrimit të veprimtarisë operative në përputhje me parashikimet e nenit 22, të ligjit nr. 57/2025, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve".
Lidhur me komentin për pikën 1, të nenit 14, të projektvendimit, sipas të cilit formulimi i saj krijon paqartësi dhe cënon zbatimin efikas të parashikimeve të projektaktit, për shkak se lejon operimin e kufizuar të venddepozitimeve të reja të përkohshme gjatë fazës së ngritjes dhe përgatitjes për miratim, sqarojmë se komenti u mor në konsideratë dhe është reflektuar në projektvendim duke e hequr nga përmbajtja e projektvendimit.

Ministria e Financave:
Lidhur me komentin se në nenin 9 të projektvendimit vendoset një kuotë minimale rikuperimi prej 45% të mbetjeve inerte dhe se përmbushja e kësaj kuote, në rastet kur operatori ka status publik, kërkon investime në infrastrukturë teknike dhe kapacitete operacionale, argumentojmë se referuar ligjit nr. 57/2025, venddepozitimet e përkohshme, kanë karakter kalimtar dhe funksionojnë për një periudhë të kufizuar, deri në ndërtimin dhe vënien në funksion të landfill-eve rajonale. Për rrjedhojë, ato nuk përbëjnë infrastrukturën përfundimtare të trajtimit të mbetjeve, por një zgjidhje të përkohshme për menaxhimin e situatës ekzistuese. Në këtë kuadër, ligji parashikon që zhvillimi, koordinimi dhe administrimi i

infrastrukturës së trajtimit të mbetjeve realizohet në nivel qendror përmes Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve (AKEM sh.a.), e cila ushtron funksione të drejtpërdrejta në planifikimin, ndërtimin dhe operimin e rrjetit kombëtar të impianteve të trajtimit të mbetjeve. Sa i përket financimit, ligji parashikon një kuadër të konsoliduar burimesh, ku AKEM siguron financim nga buxheti i shtetit, tarifat e pranimit në impiante ("gate fee"), të ardhurat nga aktiviteti dhe burime të tjera të ligjshme, ndërkohë që kostot e menaxhimit të mbetjeve mbulohen në përputhje me parimin "ndotësi paguan". Në këto kushte, kërkesa për rikuperim në masën 45% nuk lidhet me detyrimin për realizimin e menjëhershëm të investimeve nga operatori publik në mënyrë të veçuar, por me funksionimin gradual të një sistemi të organizuar në nivel kombëtar, në përputhje me zhvillimin e infrastrukturës dhe mekanizmave financiarë të parashikuar në legjislacionin në fuqi.

- Lidhur me komentin për nenin 14, që kërkon identifikimin e venddepozitimeve ekzistuese të mbetjeve inerte dhe trajtimin e tyre, argumentojmë se komenti nuk gjen zbatim në kushtet aktuale, pasi nuk rezulton të ketë venddepozitime ekzistuese të këtij lloji në funksion.
  Në këtë kuadër, dispozitat e nenit 14 janë hartuar me karakter rregullator për situata të mundshme gjatë zbatimit të aktit.

- Lidhur me komentin se projektvendimi ka ndikim mbi njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe se roli i tyre nuk është shprehur në mënyrë eksplicite, sqarojmë se ky akt synon të trajtojë një situatë të veçantë dhe të përkohshme për menaxhimin e mbetjeve inerte. Venddepozitimet e përkohshme janë konceptuar për t'u përdorur vetëm për një periudhë të kufizuar tranzitore, deri në ndërtimin dhe vënien në funksion të infrastrukturës rajonale të menaxhimit të integruar të mbetjeve, që do të administrohet nga AKEM sh.a. Për këtë arsye, organizimi i tyre nuk ndjek skemën e zakonshme të menaxhimit të mbetjeve në nivel bashkie, por është ndërtuar si një zgjidhje e centralizuar në nivel kombëtar. Në këtë kuadër, zhvillimi dhe administrimi i kësaj infrastrukture realizohet përmes AKEM sh.a., e cila vepron në shkallë kombëtare dhe bashkërendon këtë proces në mënyrë të unifikuar. Roli i bashkive në fushën e menaxhimit të mbetjeve vijon të ushtrohet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kuadrin e përgjithshëm rregullator.

- Lidhur me komentin për forcimin e dispozitave që lidhen me kontrollin dhe inspektimin në terren, sqarojmë se projektvendimi përcakton detyrimet për monitorim dhe raportim në nivel operatori, ndërsa organizimi i kontrollit dhe ushtrimi i funksioneve inspektuese nuk janë objekt i këtij akti. Këto funksione rregullohen nga legjislacioni horizontal për inspektimin dhe nga kuadri ligjor në fuqi për institucionet përgjegjëse, të cilat ushtrojnë kompetencat e tyre në mënyrë të pavarur dhe në bazë të mandatit përkatës. Në këtë kuptim, ndërveprimi dhe koordinimi ndërinstitucional zhvillohen në praktikë mbi bazën e këtij kuadri ekzistues, pa qenë e nevojshme të përcaktohen në mënyrë të detajuar në këtë akt rregullator.

- Lidhur me komentin për nenin 13, pika 5, që kërkon qartësimin e institucionit përfitues, mënyrës së depozitimit dhe procedurës së ekzekutimit të garancisë financiare, sqarojmë se është reflektuar nevoja për përcaktimin e qartë të garancisë financiare si instrument sigurie për përmbushjen e detyrimeve për mbyllje dhe rehabilitim. Ndërkohë aspektet procedurale të administrimit dhe ekzekutimit të saj rregullohen nga legjislacioni në fuqi për instrumentet financiare dhe sigurimet. Për rrjedhojë, në projektakt është përcaktuar parimi dhe qëllimi i garancisë, ndërsa mekanizmat e detajuar mbeten në kuadrin ligjor sektorial.

- Lidhur me komentin për qartësimin e mekanizmave të koordinimit ndërinstitucional, argumentojmë se projektvendimi parashikon përfshirjen e disa institucioneve në procesin e zbatimit, ndërsa koordinimi i detajuar procedural realizohet nëpërmjet instrumenteve ekzistuese të bashkëpunimit dhe sistemeve elektronike të administrimit të të dhënave.
  Në projekvendim është reflektuar parimi i bashkëpunimit institucional dhe shkëmbimit të informacionit, pa hyrë në rregullim të detajuar procedural.

- Lidhur me komentin sipas të cilit projektvendimi krijon detyrime shtesë administrative dhe monitoruese për njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe nevojën për reflektimin e kostove direkte dhe indirekte në analizën e efekteve financiare, argumentojmë se projektvendimi nuk ngarkon njësitë e vetëqeverisjes vendore me detyrime të reja operacionale, administrative apo financiare përtej kompetencave të tyre ekzistuese të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
  Përfshirja e mundshme e bashkive në proceset e bashkëpunimit institucional për identifikimin e territorit dhe përputhshmërinë me

dokumentet e planifikimit vendor nuk përbën kompetencë të re funksionale dhe nuk krijon detyrime të reja financiare që kërkojnë vlerësim të veçantë në analizën e efekteve financiare të projektaktit.

- Lidhur me komentin për nevojën e konsultimit dhe dakordësimit me NJVQV në përputhje me ligjin nr. 139/2015, sqarojmë se projektvendimi nuk ndryshon kompetencat e bashkive dhe nuk vendos detyrime të reja për to, por krijon një kuadër teknik e procedural për menaxhimin e përkohshëm të mbetjeve inerte deri në funksionalizimin e infrastrukturës rajonale përkatëse.

Përsa më sipër, projektvendimi i ripunuar dhe relacioni shpjegues u përcollen për bashkërendim tek Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave, të cilat janë shprehur parimisht dakord me variantin e ripunuar dhe argumentat e dhëna gjatë procesit të bashkrendimit.

Agjencia e Zhvillimit të Territorit me shkresën nr. 2090/2 prot., datë 23.07.2026 ka kthyer përgjigje duke kërkuar riformulimin e nëndarjes "iii" të nenit 4 ku të hiqet distanca 100 metra dhe të referohet sipas legjislacionit në fuqi për menaxhimin e burimeve ujore. Ky sugjerim u mor në konsideratë dhe u reflektua në përmbajtje të projektvendimit. Gjithashtu ka kërkuar riformulimin e pikës 5 të nenit 7 e cila u riformulua sipas sugjerimit të AZHT-së.

Projektvendimi dhe relacioni shoqërues u përcillën për shqyrtim dhe miratim në Këshill të Ministrave dhe me shkresën e datës 27 Korrik 2027 projektakti, nëpërmjet sistemit e-akte, është kthyer nga Këshilli i Ministrave, me qëllim adresimin e çështjeve të ngritura gjatë diskutimeve në mbledhjen e sekretarëve të përgjithshëm, të datës 27 korrik 2026, si dhe sigurimin e qartësisë dhe zbatueshmërisë së dispozitave të tij.

Në mënyrë të veçantë, kërkohet të rishikohen dhe adresohen këto çështje:
1. Përcaktimi i autoritetit kompetent dhe procedurës për miratimin e tarifave, pasi projektvendimi nuk përcakton autoritetin kompetent për miratimin e tarifave të menaxhimit të venddepozitimeve të përkohshme, procedurën që ndiqet për miratimin e tyre, si dhe bazën ligjore mbi të cilën ato vendosen.

Lidhur me këtë koment, sqarojmë se projektvendimi parashikon administrimin e venddepozitimeve të përkoshme nga operatorët që sipas këtij vendimi operator është çdo person fizik apo juridik që aplikon për ngritjen

dhe/ose operimin e venddepozitimit të përkohshëm të mbetjeve inerte dhe që mban përgjegjësinë për përmbushjen e kërkesave teknike, mjedisore dhe administrative të këtij vendimi. Si operator në kuptim të këtij vendimi është edhe AKEM sh.a, pasi ligji nr. 57/2025 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" parashikon AKEM sh.a si institucion përgjegjës për realizimin e projekteve për ngritjen dhe administrimin e infrastrukturës fundore të menaxhimit të mbetjeve. Për rrjedhojë, në përmbajtje të projektvendimit u shtua një nen që përcakton miratimin e tarifës së pranimit, nga njësia e vetqeverisjes vendore në rast se operator është privat dhe në rastin kur AKEM sh.a, është në cilësinë e operatorit, apo krijon një shoqëri të re me një operator privat, tarifa e pranimit miratohen në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për shoqëritë tregtare dhe statutin respektiv.

Miratimi i tarifave nga AKEM sh.a është në përputhje me qëllimin e ligjit nr.57/2025, pasi ashtu sikundër argumentuam më sipër AKEM sh.a është institucion përgjegjës për realizimin e projekteve për ngritjen dhe administrimin e infrastrukturës fundore të menaxhimit të mbetjeve dhe nga ana tjetër, kur vetë AKEM është operator, si shoqëri tregtare me kapital 100% shtetëror, organizohet dhe funksionon në përputhje me parashikimet e VKM-së 37/2026 dhe rregullat për shoqëritë tregtare, për zhvillimin e aktivitetit të saj ekonomik në funksion të interesit publik në fushën e menaxhimit të mbetjeve.

2. Përcaktimi i instrumentit juridik për vënien në dispozicion të truallit shtetëror për ngritjen e venddepozitimeve të përkohshme. Neni 7, pika 1, shkronja "b", e projektvendimit parashikon paraqitjen e dokumentacionit që provon statusin e pronësisë së truallit ose të drejtën ligjore të përdorimit të tij, pa rregulluar në mënyrë të veçantë rastin kur trualli është në pronësi shtetërore. Në veçanti, projektvendimi nuk përcakton instrumentin juridik nëpërmjet të cilit trualli në pronësi shtetërore vihet në dispozicion për ngritjen dhe funksionimin e venddepozitimeve të përkohshme, autoritetin kompetent për këtë qëllim, si dhe procedurën përkatëse.

Lidhur me këtë koment sqarojmë se në neni 14 i projektvendimit u riformulua duke shtuar me përjashtim të pikave 21/1 dhe 21/2, të parashikuara në vendimin nr. 575, datë 24.6.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte" të ndryshuar. Këto dy pika, rregullojnë aktualisht procedurën për marrjen e pronës shtetërore në administrim nga AKEM dhe do të mbeten në fuqi për zbatim nga AKEM.

Ndërkohë sqarojmë se qëllimi i projektvendimit është që AKEM në pronat shtetëror të ndërtojë vetë venddepozitimin e përkohshëm ose në rast pamundësie të krijojë shoqëri me një operator tjetër privat apo degë, ku AKEM sha do të ketë shumicën e aksioneve të shoqërisë së krijuar. Për rrjedhojë në përmbajtje të projektvendimit është shtuar një pikë që parashikon zotërimin e aksioneve nga AKEM.sha në rastin kur venddepozitimi i përkohshëm ndërtohet në pasuri shtetërore.

Ndërsa lidhur me komentin për paraqitjen e dokumentacionit që provon statusin e pronësisë së truallit ose të drejtën ligjore të përdorimit të tij, të parashikuar Neni 7, pika 1, shkronja "b", të projektvendimit, sqarojmë se ky është dokumen që kërkohet për marrjen e lejes së ndërtimit dhe provon marrëdhënien me tokën për të gjithë operatorët, në funksion të ndërtimit të venddepozitimit të përkohëshëm. Pra, operatori do të vërë në dispozicion certifikatën e pronësisë në rast së është vetë pronar ose kontratën e qerasë, përdorimit në rast se pasuria është në pronësi të një subjekti tjetër. Kur trualli është në pronësi shtetërore është AKEM sh.a që do të aplikojë për marrjen e lejes së ndërtimit vetë, nëpërmjet shoqërisë së re që do të krijojë apo degës së saj, në përputhje edhe me përcaktimet e nenit 22, pika 4 e ligjit 57/2025.

3. Qartësimi i regjimit të shoqërive që mund të krijojë AKEM, sh.a., parashikuar në nenin 10, pika 3, shkronja "b", të projektvendimit. Kërkohet përcaktimi i elementeve bazë të organizimit dhe funksionimit të këtyre shoqërive, përfshirë nivelin minimal të pjesëmarrjes së shtetit në kapitalin..

Lidhur me këtë koment sqarojmë se u riformulua shkronja "b" e pikës 3 të nenit 10 ku u specifikua shprehimisht se rast se AKEM sh.a krijon shoqëri me një operator privat në pasuri shtetërore AKEM zotëron shumicën e aksioneve të kësaj shoqërie.

Në vijim të komenteve në mbledhjen e drejtoreve juridik të datës 24 Korrik, sqarojmë si vijon:

1. Qëndrimi i Agjencisë së Zhvillimit të Territorit është reflektuar në përmbajtje të projektvendimit dhe në relacionin shoqërues.
2. Komenti se nuk nuk përmban një analizë të mjaftueshme mbi nevojën dhe planifikimin territorial të venddepozitimeve të përkohshme të mbetjeve inerte, duke mos argumentuar numrin e pritshëm të tyre, shpërndarjen territoriale sipas njësive të vetëqeverisjes vendore ose zonave të menaxhimit të mbetjeve (në kuptim të nenit 25, të ligjit nr.57/2025, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"), sqarojmë se ligji nr.57/2025 "Për

menaxhimin e mbetjeve" parashikon ndërtimin e landfilleve bazuar në zonat e menaxhimit të mbetjeve, 1 landfill për nje zonë. Ndodhur në kushtet ku zonat nuk janë miratuar atëhere vendepozitimet e parashikuara në këtë projektvendim kanë karakter të përkohshëm dhe do të përcaktohen bazuar në kriteret teknike të parashikuara në këtë vendim dhe minimumit të sipërfaqes, e cila duhet të jetë jo më pak se 5000 m2.

3. Lidhur me komentin që të jepet një shpjegim në relacion se ku konsiston ndryshimi ndërmjet një *landfill*-i për mbetjet inerte dhe një venddepozitimi të përkohshëm të mbetjeve inerte, sa kohë që në projektvendim parashikohet kërkesa minimale prej 45% të mbetjeve të pranuara duhet të rikuperohet, ndërsa maksimumi 55% të destinohet për depozitim final.
   Lidhur me këtë koment sqarojmë se landfill-i për mbetjet inerte dhe venddepozitimi i përkohshëm i mbetjeve inerte ndryshojnë thelbësisht në qëllim, funksion dhe regjim juridik: landfill-i është infrastrukturë përfundimtare për depozitimin afatgjatë të mbetjeve që nuk mund të rikuperohen, ndërsa venddepozitimi i përkohshëm është një zgjidhje tranzitore, me afat dhe kapacitet të kufizuar, që përdoret vetëm deri në funksionalizimin e infrastrukturës përfundimtare dhe nuk e zëvendëson atë. Ky i fundit synon menaxhimin e kontrolluar të mbetjeve duke i dhënë përparësi rikuperimit (minimumi 45%) dhe duke kufizuar depozitimin vetëm në fraksionin e parikuperueshëm (maksimumi 55%), pa u konsideruar landfill, edhe pse një pjesë e mbetjeve do të mbetet në vend pas mbylljes dhe rehabilitimit të objektit.
4. Lidhur me komentin se konstatohen mospërputhje terminologjike në përdorimin e disa koncepteve përgjatë projektaktit dhe anekseve, si dhe referime ligjore që kërkojnë harmonizim (neni 6, pikat 1 dhe 3, "katalogu i mbetjeve", sqarojmë se përdorimi i termit "katalogu kombëtar i klasifikimit të mbetjeve" në nenin 6, pika 3, nuk krijon mospërputhje terminologjike me pikën 1 të të njëjtit nen. Pika 1 përcakton në mënyrë përshkruese kategoritë e mbetjeve inerte që mund të pranohen, ndërsa pika 3 vendos detyrimin që identifikimi dhe klasifikimi i tyre të kryhet sipas katalogut të miratuar me legjislacionin në fuqi. Këto dispozita kanë funksione plotësuese dhe jo kontradiktore: e para përcakton natyrën e mbetjeve të pranueshme, ndërsa e dyta instrumentin juridik dhe teknik për kodifikimin e tyre.
5. Lidhur me komentet per unifikimin e terminologjisë apo qartësimin e disa parashikimeve, sqarojmë se u bënë riformulimet përkatëse të evidentuara nga Departamenti i Këshillit të Ministrave.

Projektvendimi i ripunuar bazuar në komentet e dërguara nga Departamenti i Akteve Rregullatore të Këshillit të Ministrave si dhe relacioni shpjegues u përcoll në rrugë elektronike pranë Departamentit të Bashkëpunimit Ndërinstitucional, Monitorimit dhe Akselerimit në Kryeministri, i cili në vijim të shqyrtimit të dokumentacionit të dërguar me emailin e datës 30 tetor 2026 vlerëson se projektvendimi duhet të vijojë me procesin e bashkërendimit me institucionet e interesuara dhe, pas përfundimit të këtij procesi, të përcillet për shqyrtim dhe miratim në Këshillin e Ministrave.

Përsa më sipër, projektvendimi i ripunuar përcillet për bashkërendim tek Ministria e Financave, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve të Brendshme dhe tek Agjencia e Zhvillimit të Territorit.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Zbatimi i këtij vendimi nuk parashikon krijimin e kostove të drejtpërdrejta shtesë për buxhetin e shtetit.

Kostot që lidhen me ngritjen dhe operimin e venddepozitimeve të përkohshme përballohen nga subjektet e autorizuara, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe përmes mekanizmave të tarifimit të shërbimit.

Gjithashtu, projektvendimi parashikon detyrimin për vendosjen e garancisë financiare dhe sigurimit përkatës nga operatorët, me qëllim mbulimin e kostove të mundshme për rehabilitimin e mjedisit dhe përballimin e risqeve gjatë operimit.

Institucionet shtetërore përgjegjëse ushtrojnë funksionet e tyre në kuadër të burimeve ekzistuese buxhetore.

MINISTRI I MJEDISIT

Sofjan JAUPAJ

Sofjan Jaupaj

Digitally signed by Sofjan Jaupaj
Date: 2026.11.02 15:42:05 +02'00'